

HISTORIA E GODINËS SË BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË NË DURRËS

*

KRIJIMI I BANKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË (BKSH)

Hyrje

Durrësi ka qenë gjithmonë në histori një qytet shumë i rëndësishëm për Adriatikon dhe Shqipërinë. Personazhe të famshëm të antikitetit jo vetëm kaluan dhe qendruan këtu, por edhe shkruajtën për të. Për shembull, Katuli e quajti Durrësin “*tavernë të Adriatikut*,” Ciceroni e quajti “*qytet i lirë*” ndërsa Prokopi i Çezarësë e përshkroi Durrësin si qyteti “*për të cilin buçet fama*.” Koha, përplasjet ushtarake dhe fatkeqësitë natyrore nuk ia zhbënë rëndësinë qytetit, i cili mbeti një nyje kyçe për rajonin përgjatë të gjithë mesjetës dhe periudhës bashkëkohore.

Në fillimin e shekullit të XX Durrësi përshkruhej nga udhëtarët e ndryshëm si një qytet i këndshëm me një ndërthurje të bukur stilesh arkitektonike dhe artistike të frymëzuara si nga lindja ashtu edhe nga perëndimi. Për shkak të portit, pozitës gjeografike dhe lidhjes që kishte me qytetet e prapatokës, ai mori rol edhe më të madh pas shpalljes së pavarësisë. Ishte për këtë arsye që në vitin 1914, mbreti Vid vendosi që Durrësi duhet të ishte kryeqyteti i Shqipërisë. Qyteti e mbajti këtë status për disa vite deri kur përplasjet politike dhe ushtarake e detyruan elitën vendase ta zhvendoste kryeqytetin në Tiranë. Kjo sidoqoftë nuk e cenoi veprimtarinë e Durrësit, që, për një sërë faktorësh, vazhdoi të ishte kryeqendra ekonomike e vendit edhe për disa dekada më pas.

Durrësi mes viteve 1920-1925

Pavarësisht dëmeve të pësuar gjatë Luftës së Parë Botërore, raportimet e kohës flasin për një qytet të fortë dhe të bukur. Këtë shkruan Kryqi i Kuq në një letër drejtuar Kongresit Amerikan në shtator të vitit 1920. Në të Durrësi përkufizohet si një “*port i bukur natyror i cili mund të bëhet më i miri në Adriatik*.” Me gjithë paqëndrueshmërinë e kohës “*Durrësi mban vendin e parë në jetën tregtare të Shqipërisë*.” Lidhja e Kombeve, përmes një eksperti të dërguar në Shqipëri në korrik të vitit 1922, përlloragiste se qyteti kishte eksportuar mbi 5.4 milionë franga ari produkte të ndryshme në vitin e vështirë 1921. Një nga përfundimet e raportit të përpiluar nga Albert Calmès ishte se për rritjen ekonomike të mëtejshme të Durrësit dhe Shqipërisë duhej të krijohej sa më parë Banka Kombëtare.

Përpjekje për krijimin e kësaj banke ishin bërë prej vitesh, që në vitin 1913, fill pas shpalljes së pavarësisë, por kushtet e vështira politike në të cilat ish ndodhur vendi e kishin shtyrë hapjen e saj. Vetëm nga fundi i shkurtit të vitit 1925, nën nxitjen e diplomatëve britanikë dhe italianë, qeveria shqiptare u bind për të arritur një marrëveshje, për ngritjen e *Bankës Kombëtare të Shqipërisë*. Konventa për krijimin e saj u nënshkrua në Tiranë më 15 mars 1925 midis qeverisë shqiptare e përfaqësuar nga Mufid Libohova dhe grupit financiar italian *Credito Italiano* të përfaqësuar nga Mario Alberti, ndërsa më 12 korrik të po atij viti kjo marrëveshje u publikua në Fletoren Zyrtare.

Ndërkohë më 23 prill 1925 ishte krijuar në Romë *Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë* (Societa per lo sviluppo economico dell'Albania) e cila do të njihet edhe me akronimin S.V.E.A. Qëllimi i saj ishte administrimi i një huaje prej 50 milionë frangash ari akorduar për ndërtimin e veprave publike dhe e cila do të kishte rol shumë të rëndësishëm në veprimtaritë e mëvonëshme të bankës. Nga këto investime Durrësi do të ishte ndoshta përfituesi më i madh në Shqipëri. Do të

sigurohej ndërtimi i portit, bulevardit të ri, qendrës së qytetit, një central elektrik, sistem i ri kanalizimesh dhe ujësjellësi, do të nisnin gërmimet e para moderne arkeologjike, dhe mbi të gjitha, ndërtimi i disa godinave publike si selia qendrore e Bankës Kombëtare.

Ligji organik i Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) do të miratohej në parlamentin shqiptar më 22 qershor 1925, kushtetimi zyrtar i saj do të bëhej më 2 shtator 1925 në Romë ku do të ishte edhe selia e Këshillit Administrativ, ndërsa veprimet e para bankare u bënë 10 ditë më pas. Paraja që do të emetohej do të ishte "*frangu i ari*", me nënfishat që do të quheshin "*leke*". Kartëmonedhat e para, me një vlerë të përgjithshme prej 5,000 franga ar, me prerje prej 20 frangash ar, do të hidheshin në treg më 28 shkurt 1926. Kapitali i saj nominal ishte 12.5 milionë franga ari.

Disa muaj pas kushtetimit, më 29 nëntor të vitit 1925, do të hapej në Durrës, në një godinë provizore të marrë me qira, selia qendrore e BKSH në Shqipëri, e cila do të shërbente edhe si filial i degës së Durrësit. Kësaj dege iu caktua më pas një zonë ndikimi e cila përfshinte Shijakun, Krujën, Kavajën, Peqinin dhe Elbasanin.

Brenda pak kohësh u hapën filialet në Korçë, Shkodër, Vlorë, Tiranë, dhe u parashikua hapja e filialeve në Elbasan, Peqin, Berat, Gjirokastrë dhe Sarandë. Presidenti i saj i parë ishte Mario Alberti (1884-1939) një profesor i politikave monetare në universitetin *Bocconi* të Milanos dhe një nga figurat më të spikatura të ekonomisë evropiane.

Durrësi kryeqendra ekonomike e Shqipërisë

Por përse u zgjodh Durrësi si vendi ku duhet të ngrihej selia qendrore e Bankës Kombëtare të Shqipërisë? Përse kjo seli nuk u vendos në kryeqytetin e ri, Tiranën?

Edhe pse Durrësi i vitit 1925 numëronte vetëm pak më shumë se 6,000 banorë, ai kishte limanin kryesor të Shqipërisë që siguronte lidhjen më të shpejtë dhe të sigurtë me botën perëndimore, ishte nyja kyçe e rrugëve automobilistike dhe hekurudhore të cilat po projektoheshin për t'u ndërtuar së shpejti dhe mbi të gjitha kishte një profil të theksuar tregtar. Në fakt, në qytetin e Durrësit, edhe pse popullsia ishte shumë e vogël, operonin disa nga firmat tregtare më të mëdha në vend. Familje të rëndësishme si ajo Shijaku, Dovana, Ekonomi, Nushi, Myshketa, Papaj, etj, bënin tregti me disa nga vendet më të rëndësishme të Detit Mesdhe, që nga rreth fundit të shekullit të XIX, duke qarkulluar kapitale të rëndësishme financiare.

Një faktor tjetër i rëndësishëm në përzgjedhjen e Durrësit si seli e BKSH duket se ka qenë afërsia me linjën nënujore telegrafike dhe mundësia që ajo të mbrohej në rast rreziku apo lufte nga marina e fuqishme italiane. Trekëndëshi Port-Hekurudhë-Bankë duhej të shërbente që Durrësi të kthehej në kryeqendrën ekonomike të Shqipërisë ndryshe nga Tirana e cila duhej të ishte kryeqendra politiko-administrative e vendit. Këtu nuk munguan as spekulimet gazetareske të kohës, shumë pak të besueshme, sipas të cilave Zogu dëshironte t'i rikthente Durrësit statusin e kryeqytetit të Shqipërisë.

*

HISTORIA E GODINËS NË DURRËS

Selia qendrore e Bankës Kombëtare të Shqipërisë

Selia dhe dega e Bankës Kombëtare të Shqipërisë u hap në Durrës më 29 nëntor 1925 por ajo u sistemua përkohësisht në një godinë më të vogël, rreth 100 metra në perëndim të godinës aktuale, në pritje të përfundimit të asaj që do të ishte selia e BKSH. Punimet u vonuan edhe për shkak të goditjes sizmike të 17 dhjetorit 1926 e cila solli dëmtime të mëdha në qytet. Si pasojë godina e re e Bankës nisi të ndërtohej në pranverën e vitit 1927 për të përfunduar në vjeshtën e vitit 1928, në një terren i cili i ishte blerë qeverisë shqiptare nga Banka në fillim të vitit 1927.

Më herët, në terrenin ku do të ngrihej godina e BKSH, ndodhej një bastion i ndërtuar në antikitetin e vonë mbi një shkëmb i cili nga burimet historike njihet si “*Shkëmbi i Bregut*.” Bastioni, i cili ishte riparuar disa herë në mesjetë nga bizantinët, komnenët, anzhuinët dhe osmanët, u shkatërrua në mënyrë të përkuperueshme gjatë bombardimeve që forcat aleate i bënë Durrësit më 2 tetor 1918 dhe për ndërtimin e godinës së bankës ajo duhej shembur përfundimisht. Sidoqoftë, madhësia e bankës detyroi inxhinierët të prishnin edhe ndërtesa të tjera që gjendeshin aty pranë si për shembull karantina, dogana dhe burgu i vjetër i qytetit, godina këto të dëmtuara dhe konsumuara më parë nga koha dhe luftrat e vazhdueshme.

Sipërfaqja totale e ndërtimit ishte më e madhe se 1,300 m², nga të cilat rreth 600m² i përkisnin godinës kryesore. Ajo ishte projektuar nga arkitekti i famshëm italian Vittorio Ballio Morpurgo i cili e kishte konceptuar atë sipas stilit *neoklasik*, tipike kjo e periudhës fashiste, me një fasadë imponuese të mbushur me simbole të frymëzuara nga mitologjia e lashtë greke dhe romake. Zbatimi i punimeve ndërkohë ishin ndjekur nga arkitekti Giovanni Valcolvi dhe ndihmësi i tij inxh. Amoruso ndërsa punimet i ishin besuar firmave “Mazzorana” dhe “Tamburlini & Monai”.

Inaugurimi

(9 nëntor 1928)

Në fillim të vjeshtës ajo ishte gati, ndërsa më 9 nëntor 1928 u inaugurua përmes një ceremonie madhështore për të cilën kishin ardhur në Durrës autoritetet më të larta të vendit dhe të bankës. Gazetat e kohës flasin për më shumë se 100 makina të ardhura në Durrës për rastin. Numër mbreslënës ky për kohën. Të ftuarit priteshin personalisht nga drejtori ekzekutiv i bankës Giulio Gaudenci dhe nëndrejtori i saj.

Ceremonia nisi në orën 10:30 dhe u hap nga presidenti Mario Alberti në prezencën e disa nga autoritetet më të larta shtetërore si Ministri i Financës Milto Tutulani, Ministri i Bujqësisë dhe Pyjeve Musa Juka, Ministri i Drejtësisë Hiqmet Delvina dhe Ministri i Punëve Botore Sali Vuçiterni. Ndërsa nga pala italiane kishin ardhur përfaqësuesit më të lartë nga S.V.E.A, Ministria e Punëve të Jashtme, Banka e Italisë dhe drejtori i gazetës “Mezzogiorno” të Barit. Gjatë fjalës së tij, presidenti do ta quaj godinën “*të ngritur me soliditet*”. Ndërkohë Mbretit Zog I ju dërgua një telegram në të cilin Alberti shkruante:

Lart Madhnis së Tij

Zogut I. Mbret i Shqiptarve

Tiranë

Kam nderin e nalt me komunikue se sot u inaugurua me solenitet në emnin August dhe me aspicion e sigurt të Lart Madhnis s'Uaj Selia defnitive e Bankes Kombëtare të Shqipnis që don të jetë, përveç se garancia e sigurtë e nji monëdhe të shëndosë, dhe strumenti i zhvillimit ekonomik të Shqipnis.

Nderime

Mario Alberti

Ajo funksionoi si seli e Drejtorisë Qendrore e BKSJ deri më 30 tetor 1938 kur kjo e fundit u transferua përfundimisht në Tiranë, në një godinë të ndërtuar enkas po nga i njëjti arkitekt.

*Dega Durrës
(1938-2000)*

Një moment i veçantë për Bankën ishte prilli i vitit 1939 kur Italia pushtoi Shqipërisë duke zbarkuar fillimisht në qytetin e Durrësit. Luftimet e ashpra që paraprinë zbarkimin nuk e kursyen fasadën e jashtme të Bankës e cila u godit disa herë nga artileria e marinës italiane. Ajo u riparua menjëherë më pas pa lënë gjurmë të dukshme për historinë në vazhdim.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore godina vazhdoi të luante rolin e degës së BKSJ në Durrës edhe pse gjatë dy momenteve ajo e kufizoi shumë veprimtarinë e saj. Momenti i parë ishte mes 11 dhe 20 shtatorit 1943 kur Italia u detyrua të kapitullonte dhe si pasojë veprimet e bankës u kufizuan shumë. Ndërsa mes dhjetorit të vitit 1943 dhe prillit të vitit 1944 veprimtaria e bankës u kufizua ndjeshëm pas evakuimit të plotë që gjermanët i bënë qytetit. Gjatë kësaj periudhe ajo funksiononte vetëm në funksion të makinerisë gjermane të luftës.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, më datë 13 janar 1945 mori vendimin të mos e njohë Bankën Kombëtare të Shqipërisë të krijuar më 1925 dhe si pasojë vendosi të krijonte një bankë të re e cila do të ishte 100% shtetërore. Ajo do të quhej “Banka e Shtetit Shqiptar” (BSHSH) dhe u përrua zyrtarisht më 22 janar të vitit 1945. Do të ishte kjo bankë që do të merrte nën administrim edhe godinën e ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë që ndodhej në Durrës.

Në vitin 1967, në qytet pati diskutime serioze për prishjen e skulpturës femërore që ndodhej në krye të godinës së Bankës me arsyetimin se ajo i përkiste një të kaluarë fashiste, se glorifikonte elementët pagan, ushqente bestytinën dhe shfaqte pamje e imazhe të papërshtatshme për popullin. Këto arsyeime u kundërshtuan me forcë nga arkeologët dhe historianët durrsakë të cilët i parashtruan autoriteteve rëndësinë e asaj skulpture. Kompromisi i gjetur ishte ruajtja e saj dhe mbulimi me një nga parrullat propagandistike të kohës e cila më vonë do të hiqej pas rënies së regjimit komunist.

Më 12 dhjetor 1969 në Shqipëri u krijua “Banka Bujqësore” (BB) e cila e filloi veprimtarinë e saj më 1 janar 1970. Kjo Bankë do të kishte në rrethin e Durrësit një degë e cila ndodhej në të njëjtën godinë me BSHSH. Kësisoj, pas vitit 1970 godina e Bankës në Durrës strehonte në gjirin e saj dy banka njëkohësisht.

Pas ndryshimeve të mëdha politike që pasuan vitin 1990 edhe ekonomia e vendit ndryshoi plotësisht në drejtim të ekonomisë së tregut. Ky orientim i ri lindi nevojën për një sistem të ri bankar. Kështu më 31 korrik 1991 u krijua “Banka e Kursimit”, më 16 tetor 1991 u krijua “Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit”, më 1 dhjetor 1990 u krijua “Banka Shqiptare e Tregtisë” ndërsa më 25 qershor të vitit 1992 u krijua “Banka Kombëtare e Shqipërisë.”

Banka e Shtetit Shqiptar u zëvendësua më 22 prill 1992 nga “Banka e Shqipërisë.” Kjo e fundit tashmë do të funksiononte si Bankë e nivelit të parë ndërsa bankat e tjera si banka të nivelit të dytë.

Më 30 dhjetor të vitit 1992, Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe Banka Shqiptare e Tregtisë u bashkuan duke krijuar “Bankën Kombëtare Tregtare të Shqipërisë” e njohur edhe si BKT, dega e së cilës në Durrës do të vendosej në godinën aktuale. BKT arriti të privatizohej me sukses më 6 korrik të vitit 2000 duke kaluar si bankë me kapital privat.

Në vitin 1997 godina e Bankës u tentua të grabitej por niveli i lartë i sigurisë e pamundësoi një gjë të tillë dhe përveç disa dëmtimeve në fasadë, ajo nuk pësoi dëme të tjera.

Aktualisht godina e Bankës gëzon statusin “*Monument kulture i kategorisë së dytë*” dhe i është nënshtruar një rikonstruksioni të thellë që ka rinxjerrë në dritë vlerat e jashtëzakonshme urbanistike, arkitekturore dhe estetike që ajo ka për qytetin e Durrësit.

*

SIMBOLET

Fascio

Fascio ishte një armë e cila më pas u kthye në një simbol. Ajo u përdor masivisht nga romakët edhe pse gjasat janë që ata e morën nga etruskët. Përdorimi i saj daton që në antikitet, ndoshta që nga shekulli i 7-6 p.e.s. Fillimisht ishte një armë-simbol e cila përdorej për të ekzekutuar të dënuarit me vdekje. I dënuari duhet të kuptonte se dënimi i ishte dhënë nga populli dhe se ekzekutimi i tij bëhej po nga populli. Kështu shufrat prej druri të bashkuara nga rripa lëkure, simbolizonin gjykimin e popullit romak. Këtyre më vonë iu bashkëngjit një sopatë.

Fascio (*fascis lictoria*), siç nisi të quhej arma, u kthye ngadalë në simbol të autoritetit i cili kishte pushtet mbi jetën dhe vdekjen. Në periudhën republikane u bë simbol i unitetit dhe forcës popullore. Pasi u përdor shpesh në historinë moderne evropiane, *fascio* u bë simboli i partisë së ekstremit të djathtë në Itali nga ku më pas partia mori edhe emrin: *Fascio* - Fashizëm. Më 30 dhjetor 1926 *fascio* u shpall emblema e shtetit Italian duke u përpjekur të simbolizonte jo vetëm unitetin dhe forcën e popullit por edhe të evokonte lidhjen e pandashme që kishte me perandorinë romake.

Gruri

Më 20 qershor 1925 regjimi i Benito Musolini-t shpalli atë që do të njihej si Beteja e Grurit e cila synonte mbulimin e nevojave për grurë nga produkti vendas në masën 100%. Ishte një politikë e ashpër autarkizmi e cila synonte të ndërpriste varësinë që Italia kishte nga gruri i importuar i cili asajkohe arrinte në 1/3 e konsumit total.

Figura femërore

Figura femërore e vendosur mbi godinën e Bankës është figura më përfaqësuese e godinës. Sidoqoftë, ndryshe nga çfarë mbështesin legjendat urbane të qytetit të Durrësit, ajo nuk duket se i përket mbretëreshës Teuta. Të paktën një gjë e tillë nuk tregohet nga dokumentet e njohura deri më sot.

Skulptori i statujës quhej Gianni Remuzzi dhe ishte nxënësi i Angelo Zanellit, ky i fundit autori i skulpturës “*Dea Roma*” në monumentin e famshëm “*Altare Della Patria*” në Romë. Shumë pak kohë më pas Remuzzi nisi punën për skulpturën e Durrësit dhe ka shumë gjasa që ai të jetë frymëzuar nga mësuesi i tij për realizimin e kësaj vepre. Ajo me siguri përfaqëson historinë e qytetit të lidhur fort kulturalisht me antikitetin, mesdheun, detin dhe luftën. Sipas gazetave të kohës “*shtati i guri*” që ndodhet në fasadën qendrore të Bankës “*nënyfyturon ekonominë shqiptare*”.

Simboli V

Banka gjithashtu ka një formë që, e parë nga lart, kujton formën V, e cila është e njëjta formë si ajo e Rezidencës Qeveritare (Vila e Zogut). Në fakt kjo formë ka disa kuptime, mes së cilave atë të një shqiponjë në fluturim, simbol ky i fortë i Shqipërisë. Por mbi të gjitha ajo është një simbol i fitores (*Vittoria*) dhe aleancës me fashizmin.

Numri 3

Një rol tepër të rëndësishëm ndërkohe luante në simbologjinë fashiste edhe numri 3. Për shembull 3 ishin urdhëresat kryesore: *Besim - Bindje - Luftë*. Siç nga ana tjetër ishin 3 edhe inicialet e partisë P.N.F (*Partito nazionale fascista*), 3 ishin anëtarët e aleancës (Italia, Gjermania, Japonia), 3 ishin fazat shpirtërore dhe intelektuale të cilat kalonte fashisti i ri për t’u pranuar në parti, 3 ishin përgjithsisht nënsekretarët e partisë, dekada e 3-të e shekullit të XX ishte dekada e ngjitjes fashiste, etj. Ky numër shfaqet shpesh tek elementët stilistik dhe arkitektonik të Bankës së Durrësit.

Helmeta me krahë

Helmeta me krahë perdorej gjërësisht nga popullsitë kelte. Më pas ajo u adaptua nga romakët të cilët e përdornin atë në korelacion me hyjin Mërkur, patron i tregtisë, i udhëtarëve dhe çuditërisht i kusarëve. Helmeta me krahë perdorej shumë edhe nga popujt italik dhe nga ushtria perandorake romake deri në mesjetë.

Në mbyllje, jo vetëm institucioni apo edhe godina e Bankës e cila gëzon statusin “*Monument kulture i kategorisë së dytë*” duke shpalosur vlerat e jashtëzakonshme urbanistike, arkitekturore dhe estetike për Durrësin, por i gjithë historiku i krijimit dhe zhvillimit të kësaj banke mbetet një trashëgimi e vyer për qytetin, një dëshmi e prekshme dhe e rëndësishme e të gjitha etapave që ka kaluar Durrësi gjatë të gjithë shekullit të fundit.

*

KRONOLOGJIA

- **4 tetor 1913** – Firmoset “*akti konçesie*” midis qeverisë shqiptare dhe një grupi sipërmarrësish italian dhe austriak për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Për arsye të kushteve të komplikuar politike në të cilat ndodhej Shqipëria, Ballkani dhe Europa, kjo marrëveshje nuk gjeti kurrë zbatim.
- **21 shkurt 1925** – Qeveria shqiptare nis bisedimet me Ugo Sole, i ngarkuari me punë i Italisë në Shqipëri, për hapjen e një Banke Kombëtare Shqiptare.
- **15 mars 1925** – Qeveria shqiptare, e përfaqësuar nga Mufid Libohova dhe grupi financiar italian *Credito Italiano* i përfaqësuar nga Mario Alberti, arrin marrëveshjen për krijimin e “*Bankës Kombëtare të Shqipërisë*”.
- **22 qershor 1925** – Miratohet në parlamentin shqiptar ligji organik i Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) do të miratohej
- **12 korrik 1925** – Marrëveshja u publikua në Fletoren Zyrtare të qeverisë shqiptare.
- **2 shtator 1925** – Bëhet në Romë kushtetimi zyrtar i BKSH.
- **29 nëntor 1925** – Disa muaj pas kushtetimit, do të hapej në Durrës, në një godinë provizore, selia qendrore e BKSH në Shqipëri, e cila do të shërbente edhe si filial i degës së Durrësit. Kësaj dege iu caktua më pas një zonë ndikimi e cila përfshinte Shijakun, Krujën, Kavajën, Peqinin dhe Elbasanin.
- **28 shkurt 1926** – Hidhen në treg kartëmonedhat e para, me një vlerë të përgjithshme prej 5,000 franga ar dhe me prerje prej 20 frangash ar. Nënfishat e saj do të quhen “*leke*”
- **Mars 1927** – Banka Kombëtare e Shqipërisë, pas më shumë se një viti negociata, i blen qeverisë shqiptare një sipërfaqe toke prej 1010 m² e cila duhet të shërbente për ndërtimin e Selisë qendrore të BKSH.
- **Prill 1927** – Nisin punimet për ndërtimin e selisë qendrore të BKSH në Durrës. Ndërtesa ishte projektuar nga arkitekti italian Vittorio Ballio Morpurgo ndërsa skulptura dhe relievet e saj nga skulptori italian Gianni Remuzzi.
- **26 mars 1928** – BKSH blen nga shteti shqiptarë edhe 338 m² të tjera terren për ndërtimin e godinës së bankës dhe objekteve të tjera që duheshin ndërtuar në funksion të saj.
- **9 nëntor 1928** – Hapet selia e re qendrore e BKSH. Godina e re, shumë afër portit, shërbente edhe si dega e kësaj banke për rrethin e Durrësit.
- **30 tetor 1938** – Pas 10 vjetësh selia qendrore e BKSH transferohet nga Durrësi për në Tiranë, në një godinë të ndërtuar enkas nga i njëjti arkitekt.

- **11-20 shtator 1943** – Dega e BKSH në Durrës kufizon ndjeshëm veprimet e veta bankare për shkak të kapitullimit të Italisë dhe pezullimit të veprimtarive të Bankës Qendrore.
- **Dhjetor 1943-prill 1944** – Dega e BKSH në Durrës kufizon ndjeshëm për herë të dytë veprimtarinë e saj bankare për shkak të evakuimit total që ju bë qytetit nga trupat naziste.
- **13 janar 1945** – Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, mori vendimin të mos e njohë Bankën Kombëtare të Shqipërisë. Si pasojë ajo pushoi se ekzistuari.
- **22 janar 1945** – Hapet zyrtarisht “*Banka e Shtetit Shqiptar*” (BSHSH). Godina e Durrësit i kalon nën administrim BSHSH.
- **1 janar 1970** – Nis veprimtarinë banka e sapokrijuar “*Banka Bujqësore*” (BB). Kjo Bankë do të kishte në rrethin e Durrësit një degë e cila ndodhej në të njëjtën godinë me BSHSH. Kësisoj, pas vitit 1970 godina e Bankës në Durrës strehonte në gjirin e saj dy banka njëkohësisht.
- **1 dhjetor 1990** – U krijua “*Banka Shqiptare e Tregtisë*”.
- **22 prill 1992** – Banka e Shtetit Shqiptar zëvendësohet nga “*Banka e Shqipërisë*.” Kjo e fundit tashmë do të funksiononte si Bankë e nivelit të parë ndërsa bankat e tjera si banka të nivelit të dytë.
- **25 qershor 1992** – U krijua “*Banka Kombëtare e Shqipërisë*”.
- **30 dhjetor 1992** – Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe Banka Shqiptare e Tregtisë u bashkuan duke krijuar “*Bankën Kombëtare Tregtare të Shqipërisë*” e njohur edhe si BKT dega e së cilës në Durrës do të vendosej në godinën aktuale.
- **6 korrik 2000** – BKT arriti të privatizohej me sukses duke kaluar si bankë me kapital privat. Ajo është sot banka më e madhe në Shqipëri dhe ka trashëguar me krenari godinën më të bukur në qytetin e Durrësit.
- **30 mars 2018** – Ministria e Kulturës, përmes Urdhërit numër 197, dt. 30.03.2018, shpall godinën e Bankës Kombëtare Tregtare në Durrës “*Monument kulture i kategorisë së dytë*”.

DOKUMENTE

1. AQSH. F. 149. Kryeministria. III. D. 1530
2. AQSH. F. 179. Banka Kombëtare e Shqipërisë. 1926. D. 106
3. AQSH. F. 179/2. Dega e Bankës Durrës. 1929. D. 1-77
4. AQSH. F. 236. Bashkia e Durrësit. 1923. D. 1-31
5. BKSH. Fletorja Zyrtare. 12 korrik 1925. Tiranë

BIBLIOGRAFIA

1. Di Nicola Andrea. *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare*. Tiranë 2013
2. Duka Valentina. *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*. Tiranë 1997
3. Frashëri Kristo. *Monedha, krediti dhe banka në Shqipëri gjatë shekujve*. Tiranë 2011
4. Grup Autorësh. *Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri*. Tiranë 2003.
5. Grup Autorësh. *Historiku i Bankave në Shqipëri*. Tiranë 2012.
6. Hidri Sali. *Durrësi 1900-1939*. Lecce 1997.
7. Jean Chevalier & Alain Gheerbrant. *A Dictionary of Symbols*. 1994
8. Martucci Giorgio. *Albania 1912-1937. Le opere pubbliche nei primi 25 anni di indipendenza*, Brindisi-Lecce 2006
9. Renzo De Felice. *Autobiografia del fascismo*. Bergamo, Minerva Italica, 1978
10. Roselli Alessandro. *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period*. Neë York 2006
11. Shkoza Haxhi. *Financat e Shqipërisë*. Tiranë 2016
12. Sula Ali. *Reminiscenze Durazzone*. Lecce 2002
13. Treccani Encyclopedia

REVISTA & GAZETA

1. Gazeta e Re. 10 nëntor 1928
2. Gazeta Shekulli i Ri. 10 nëntor 1928
3. Gazeta Shekulli i Ri. 8 nëntor 1928
4. Gazeta Shqiptare. 18 nëntor 1928
5. Revista Klan. 7 nëntor 2008